



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 152/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Petrit Bucaliu aktivist i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të sulmit verbal, gjatë ditës së votimit për raundin e dytë të zgjedhjeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën gjobë detyrohet që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, ndërsa Petrit Bucaliut, aktivist nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, i ndalohet për 3 (tre) vite nga plotfuqishmëria e këtij vendimi që të marrë pjesë si kandidat ose si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor në Zgjedhje të organizuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me datën 27.05.2012, PZAP-i, ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik PDK dega Ferizaj, me të cilën pretendohet se me datën 27.05.2012 gjatë ditës së votimit në Qendrën e Votimit (QV) 2502x, aktivisti i LDK-së me Petrit Bucaliu ka shkuar në QV të sipershënuar për ti furnizuar me ushqim dhe shërbime tjera. Sipas parashtruesit të ankesës personi në fjalë pas përfundimit të detyrës është sjellur poshtë e lartë korridoreve, të njëjtit i është tërhequr vërejtja nga ana e menaxherit të QV-së, por ai është përgjigjur me fjalë fyese dhe arrogante ndaj menaxherit të QV-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi deklaratën e datës 27.05.2012 te Milazim Dërgutit - menaxher i QV2502x në të cilën thekson se Petrit Bucaliu është endur poshtë e lartë nëpër korridorin e kësaj QV si dhe pas insistimit të tij për ta larguar ai e ka fyer në mënyr banale.

PZAP-i, me qëllim të krahasimit dhe vërtetimit të pretendimeve të ankesës së paraqitur nga Subjekti Politik i lartpërmendur me datë 28.05.2012, përmes shkresës nr. 152/2 të datës 28.05.2012 nga subjekti politik LDK ka kërkuar informata, sqarime dhe prova lidhur me pretendimet e paraqitur ane ankesë.

PZAP-i, po ashtu lidhur me këto pretendime të paraqitura në ankesë ka kërkuar informata dhe raport më të detajuar nga Policia e Kosovës.

PZAP-i për të vërtetuar në mënyrë të drejtë çështjen faktike, administroi provat që gjenden në shkresat e lëndës si: pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë të kryesit të supozuar dhe raportin policor, gjeti se ankesa është e bazuar.

Nga pretendimet ankimore rezulton se Petrit Bucaliu e ka fyer rëndë menaxherin QV2502x, pasi që ky i fundit ia ka tërhequr vërejtjen që mos të endet poshtë e lart në QV.

Nga Raporti Policor me nr. 2012 – CF-1038, vërtetohet se ndaj Petrit Bucaliu është hapur rasti zyrtar për prishje te rendit dhe qetësisë publike në gjykatën për kundërvajtje si "Sulm verbal" i sankzionuar me ligjin mbi rendin dhe qetësinë publike nen 5 pika 1.

Subjekti Politik LDK në përgjigjen e dorëzuar ne PZAP me datën 29.05.2012 ka mohuar pohimet e pretenduara nga parashtruesi i ankesës, dhe thekson se Petrit Bucaliu nuk është sjellë poshtë e lartë, por ai ka shkuar në VV vetëm për të furnizuar me bukë vëzhguesit dhe komisionerët. Prandaj pretendimet e përgjigjes në ankesë të paraqitura nga Subjekti Politik LDK sipas Panelit të PZAP-it janë të pabazuara ngase provat e tjera të administruar vërtetojnë të kundërtën.

PZAP-i pas vlerësimit të gjitha provave të administruara dhe duke i marr parasysh të gjitha rrëthanat konstatoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me sulm verbal të shkaktuar nga ana e Petrit Bucaliut aktivist i subjektit politik LDK, në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 e 2, nen 120 paragrafi 1 pika (c), paragrafi 3 pika (d) dhe nenit 115 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) andaj duke qenë se për shkeljen e lartpërmendur i është shqiptuar ndalesa si në dispozitiv personit i cili drejtpërdrejtë ka kryer këtë shkelje si dhe subjekti politik i është shqiptuar gjoba s në dispozitiv, PZAP-i gjen se me dënimin e shqiptuar në tërësi si në dispozitiv do të arrihet qëllimi i dënimit.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa në Prishtinë

Anr. 152/2012 më datën 30.05.2012.

